



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. 1062 Prot.

Tiranë, më 10 . 03 .2026

Lënda: Kërkesë për mbledhjen e Komisionit.

Drejtuar: Z. IGLI HASANI

Kryetar i Komisionit për Europën dhe Punët e Jashtme

Zoti Kryetar,

Ne një grup deputetësh, anëtarë të Komisionit për Europën dhe Punët e Jashtme, jemi njohur përmes medias, se më 28 shkurt 2026, Kryeministri Edi Rama, me bashkëautorësi të Presidentit serb Aleksandër Vucic kanë publikuar një editorial në median gjermane Frankfurter Allgemeine Zeitung. Sëbashku, ata kanë bërë një propozim publik drejtuar Bashkimit Europian për një qasje të re në procesin e zgjerimit drejt vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke hequr dorë nga anëtarësimi i plotë dhe u vetëmjaftuar me një integrim të vendeve kandidate vetëm në tregun e brendshëm dhe zonën Schengen.

Ky qëndrim i Kryeministrit Edi Rama bie në kundërshti me Rezolutat e miratuara më herët në Kuvendin e Shqipërisë, ku shprehet qartësisht vullneti për anëtarësimin e plotë në BE si objektiv madhor dhe strategjik, të rikonfirmuar përmes deklaratave të përbashkëta Shqipëri-BE në kuadër të Komitetit Ndërparlamentar të Stabilizim Asocimit. Njëjtë, shkel parimet e Kuadrit Negociator Shqipëri-BE, që përbën një angazhim kontraktual me Bashkimin Europian. Dhe më e rëndësishmja, cenon interesat strategjike të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës, dhe në tërësi të faktorit shqiptar në rajon. Publikimi i këtij propozimi vecanërisht tani, kur bota përballet me zhvillime të paparashikueshme dhe të shpeshta, zhvendosja e Shqipërisë nga shinat e anëtarësimit në, përbën një aventurë të rrezikshme.

Bashkimi Europian përmes Samitit të Goteborgut (2001), Agjendës së Selanikut (2003) ka përcaktuar qartë se vendet e Ballkanit Perëndimor kanë një perspektivë të plotë anëtarësimi që bazohet mbi aftësinë/meritën e secilit vend për të përmbushur detyrimet që njihen si kriteret e Kopenhagës. Në vijim, BE ndërtoi dhe Procesin e Berlinit (2014) dhe Planin Ekonomik të Rritjes (2024-2027) për të nxitur përshpejtimin e proceseve të anëtarësimit, por pa i zëvendësuar apo ndryshuar ato. Shqipëria është vendi që ka tërhequr më pak para në rajon nga procesi i Berlinit. Situata ndryshoi me miratimin e Planit Ekonomik të Rritjes, ku deri tani janë përfutur rreth 100 milionë euro fonde, nga të cilat 46.2 milionë euro për reforma strukturore, dhe 54.1 milion (grante dhe kredi) për investime në infrastrukturë.

Mirëpo Shqipëria ka zbatuar vetëm 21 detyra/reforma nga 143 që duhet të përmbushë deri në 2027, apo 21 nga 70 që pretendohet se ka realizuar. Jo vetëm kaq por edhe fondet që janë dhënë për projekte në fushat e energjisë, digjitalizimit, dhe infrastrukturës, përkojnë me të njëjtët sektorë ku kanë shpërthyer dhe skandalet më të mëdha korruptive, me një numër zyrtarësh dhe bashkëpunëtorësh, përfshirë ish-zëvendëskryeministren, të vendosur nën akuzë nga SPAK.

Me qëllim shmangien e vëmendjes nga këto skandale, Kryeministri nuk mundet të ndryshojë kursin strategjik të Shqipërisë, e aq më pak, ta bëjë këtë në emër të vendit. Për më tepër ndërmarrja e kësaj nisme me Presidentin e Serbisë, i cili po ashtu përballet me kushtëzime të rrepta të BE, për shkak të miratimit të ligjeve anti-europiane dhe moslinjësimit të politikës së jashtme dhe sigurisë serbe me atë të Bashkimit Europian, krijon dyshime të forta dhe të arsyeshme se po keqpërdoret perspektiva europiane e rajonit si alibi e përbashkët për t'i shpëtuar përgjegjësisë ligjore dhe politike, mbikqyrjes europiane dhe kushtëzimeve të forta politike që mbart ky proces.

Kujtojmë po ashtu se vetëm pak ditë përpara këtij editoriali të përbashkët, Presidenti Vucic ka deklaruar se nuk do ta njohë kurrë Kosovën, ndërkohë që gjatë dy viteve të fundit ai është angazhuar me të gjitha mjetet, përfshirë mbështetjen e sulmit terrorist të Banjskës, kundër Kosovës, sovranitetit dhe tërësisë së saj territoriale, dhe ka minuar dialogun e ndërmjetësuar nga BE, përfshirë moszbatimin e marrëveshjeve të arritura në këtë kuadër.

Me qëllim garantimin efektiv të vullnetit të shprehur nga Kuvendi, si dhe të interesave strategjike kombëtare, në mbështetje të nenit 32, pika 2 dhe nenit 36, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, kërkojmë mbledhjen e Komisionit për Europën dhe Punët e Jashtme, në seancë dëgjimore me Kryeministrin Edi Rama, deri në datë 17.03.2026, për llogaridhënie për propozimin me bashkëautorësi të Presidentit serb.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

DEPUTETËT

Albena Vohshi
Enkel Kexari
Edmond Dauti
Sgjeri
Tomor Hixhi
Tutun Hixhi